

20081031961

L I G J **PËR TË MIRAT AUDIOVIZUELE**

I. DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Lenda e rregullimit

Neni 1

Me kete ligj rregullohen kushtet dhe menyra e punes së kinotekave, kryerja e veprimtarise së kinotekave, themelimi, llojet e kinotekave, organizimi, koordinimi, të drejtat dhe detyrimet e poseduesve të të mirave audiovizuele, mbikeqyrja, titujt profesionale dhe ceshtje të tjera me rendesi për kryerjen e veprimtarise për mbrojtjen e të mirave audiovizuele.

Të mirat audiovizuele

Neni 2

Të mira audivizuele në pajtim me kete ligj jane:

- veprat audivizuele (materiale burimore dhe kopjet tonike të filmit artistik, dokumentar, të vizatuar, eksperimentues dhe alternativ, si dhe të veprave të tjera audiovizuele të shprehura në forme fotografish levizese të lidhura me ton apo pa ton, pa marre parasysh llojin e bartesit, të dedikuar për shfaqje publike) dhe
- materialet shoqeruese që kane të bejne me fotografit levizese, siç jane dokumentacioni i shkruar, skenaret, librat në incizim, skicat skenografe dhe kostumografe, kostumet, rekuizitat skenografike, mikrofilmat, fotografite, diapozitivat, pllakatet dhe materialet tjera propaganduese.

Të mirat audivizuele të mbrojtura

Neni 3

(1) Të mirat audiovizuele nga neni 2 i ketij ligji, të cilat për shkak të vlerave, dukurive, permbajtjeve ose funksioneve të veta, kane rendesi kulturore, shkencore dhe historike dhe jane të evidentuara në librin e inventarit të kinotekes publike ose u eshte vendosur mbrojtja apo në menyre tjeter mbrohen si trashegimi kulturore, në pajtim me kete ligj dhe Ligjin për mbrojtje të trashegimise kulturore.

(2) Ekzemplari i detyrueshem që i dorezohet Kinotekes së Maqedonise, të percaktuar me kete ligj, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashegimise kulturore konsiderohet si trashegimi kulturore me rendesi të madhe të mbrojtur në baze të ligjit.

Rendesia e shprehjeve të caktuara në kete ligj

Neni 4

(1) Kopje arkivore në kuptimin e ketij ligji eshte kopja tonike e të mires audiovizuele, e dedikuar për ruajtje dhe mbrojtje për shkak të nevojave kulturore, shkencore dhe historike.

(2) Material burimor në kuptimin e ketij ligji jane të gjitha shkresat në fotografi dhe ton të cilat jane baze për krijimin e të mires audiovizuele.

(3) Producent në kuptimin e ketij ligji eshte producenti i regjistruar në regjistrin Qendror të Republikes së Maqedonise me veprimtari kryesisht produksion filmi.

Kinoteka

Neni 5

(1) Kinoteka eshte institucion jofitimprues nga sfera e kultures.

(2) Kinotekat bejne kerkimin, grumbullimin, evidentimin, katalogjizimin, perpunimin profesional dhe shkencor, ruajtjen, mbrojtjen dhe shfaqjen e të mirave audiovizuele.

Veprimtaria për mbrojtjen e të mirave audiovizuele

Neni 6

- (1) Veprimtaria e mbrojtjes së të mirave audiovizuale është me interes publik.
- (2) Veprimtarinë për mbrojtjen e të mirave audiovizuale në baze të dispozitave të këtij ligji e kryejnë kinotekat dhe permbledhjet e pavarura audiovizuale, nëse janë të regjistruara për kryerjen e veprimtarisë për mbrojtjen e të mirave audiovizuale (në tekstin e metutjeshëm: kinotekat).
- (3) Veprimtari për mbrojtjen e të mirave audiovizuale mund të kryejnë dhe persona të tjere juridike, nëse janë të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë për mbrojtjen e të mirave audiovizuale dhe të njëjten e kryejnë në pjesë të vecanta të organizuar nën kushte të percaktuara me këtë ligj apo ligj tjetër, si kinoteka në përberje.

Zbatimi i dispozitave tjera

Neni 7

- (1) Në themelimin, punën dhe nderprerjen e kinotekave, udhëheqjen, administrimin, vendosjen, financimin dhe mbikeqyrjen administrative, zbatohen dispozitat e Ligjit për kulturën, nëse me këtë ligj ose me tjetër ligj nuk është rregulluar ndryshe.
- (2) Mbrojtja e të mirave audiovizuale kryhet në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- (3) Mbi kryerjen e veprimtarisë për mbrojtjen e të mirave audiovizuale zbatohet Ligji për të drejtën autoriale dhe të drejtat e ngjashme.

II. LLOJET E KINOTEKAVE DHE THEMELIMI

Llojet e kinotekave sipas themeluesit

Neni 8

- (1) Kinotekat sipas themeluesit mund të jenë publike (nacionale dhe lokale) dhe private.
- (2) Kinoteke nacionale mund të themelojë Qeveria e Republikës së Maqedonise, ndërsa kinoteke lokale mund të themelojnë komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit.
- (3) Kinoteke private mund të themelojë personi vendës dhe i huaj juridik dhe fizik, nën kushte dhe mënyrë të percaktuar me këtë ligj ose ligj tjetër.

Kushte të vecanta për fillimin me e kinotekës me punë

Neni 9

- (1) Kinoteka, në pajtim me ligjin mund të fillojë me punë nëse i plotëson kushtet e vecanta si vijon:
 - 1) të jenë siguruar mjete themelore për fillim me punë;
 - 2) të jenë siguruar mjete financiare për kryerjen e qëndrueshme të veprimtarisë;
 - 3) të ekzistojë elaborat për themelimin e kinotekës;
 - 4) të jenë siguruar lokale dhe pajisje perkatese për ruajtjen dhe shfrytëzimin e të mirave audiovizuale;
 - 5) të jenë siguruar fond perkates i të mirave audiovizuale dhe
 - 6) të ketë të punësuar kuader profesional.
- (2) Për plotësimin e kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e kultures (në tekstin e metutjeshëm: ministër) miraton aktvendim sipas mendimit të marre paraprakisht nga kinoteka amë nga neni 17 i këtij ligji.
- (3) Kunder aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni mund t'i parashtrohet ankese Komisionit të shkallës së dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonise. Ankesa nuk e prolongon aktvendimin.

(4) Standardet për percaktimin llojeve të kinotekave, për punen e tyre, për vendosjen dhe ruajtjen e të mirave audiovizuele, i percakton ministri.

III. THEMELIMI, UDHEHEQJA, ADMINISTRIMI DHE FINANCIMI I KINOTEKAVE LOKALE DHE PRIVATE

Themelimi i kinotekave lokale

Neni 10

(1) Keshilli i komunave, të Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, merr vendim për themelim të kinotekes lokale, në baze të kushteve të percaktuara në kete ligj.

(2) Kinoteka lokale ka statut, me të cilen rregullohet puna dhe organizimi i kinotekes, emri, selia, lenda e punes dhe ceshtjet tjera që jane me rendesi për punen e kinotekes të percaktuara me kete ligj apo ligj tjetër.

(3) Keshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit jep pelqim për statutin.

Udheheqja me kinotekat lokale

Neni 11

(1) Organ i për udheheqje me kinoteken lokale eshte drejtori.

(2) Kryetari i komunes e zgjedh dhe shkarkon drejtorin e kinotekes.

(3) Drejtori i kinotekes zgjidhet sipas konkursit publik që shpallet në mjetet për informim publik, më së voni deri në tre muaj para skadimit të mandatit të drejtorit paraprak. Konkursin e shpall kryetari i komunes.

(4) Kandidatet ia dergojne dokumentet e nevojshme në pajtim me konkursin keshillit drejtues të kinotekes. Kandidatet për drejtor detyrimisht paraqesin propozim-programin e vet për punen e kinotekes.

(5) Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anetaresh i formuar nga keshilli drejtues i kinotekes. Komisioni eshte i detyruar që në afat prej pese ditesh nga perfundimi konkursit t'i shqyrtoje dokumentet e derguara.

(6) Komisioni i dergon kryetarit të komunes propozimin e kandidateve.

(7) Kryetari i komunes, në afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes së propozimit bën zgjedhjen e drejtorit.

(8) Drejtori zgjidhet me mandat prej kater vjetesh me mundesi për rizgjedhje.

(9) Kandidatet të cilet nuk jane zgjedhur, në afat prej tete ditesh nga dita e pranimit të vendimit të kryetarit të komunes, kane të drejte për ankese lidhur me zbatimin e procedures për zgjedhjen e drejtorit te Komisioni i shkalles së dyte të Qeverise së Republikes së Maqedonise kompetente për zgjidhjen e ceshtjeve nga sfera e marredhenieve të punes.

(10) Kunder vendimit të Komisionit nga paragrafi (9) i ketij neni, kandidati ka të drejte për padi te gjykata themelore kompetente.

(11) Kushtet e vecanta për zgjedhjen e drejtorit dhe procedura rregullohen me statutin e kinotekes.

(12) Në rastin kur nuk eshte zgjedhur drejtori i kinotekes ose para kohe i eshte nderprere mandati, kryetari i komunes menjehere emeron ushtrues të detyres drejtor, pa konkurs, nga radhet e të punesuarve. Ushtruesi i detyres drejtor emertohet për kohen deri në zgjedhjen e drejtorit të kinotekes, ndersa më së shumti për gjashte muaj.

(13) Ushtruesi i detyres drejtor i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet e drejtorit të kinotekes.

Udheheqja me kinotekat lokale

Neni 12

(1) Organ i udheheqjes së kinotekes lokale eshte keshilli drejtues.

(2) Keshillin drejtues e perbejne pese perfaqesues të cilet i emeron keshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit nga të cilet tre jane perfaqesues nga radhet e personave të shquar profesionale nga sfera e kultures dhe dy perfaqesues nga radhet e të punesuarve në kinoteke.

(3) Keshilli drejtues i kinotekes e miraton statutin e kinotekes, e percakton politiken dhe principet për zhvillimin e kinotekes, e propozon programin vjetor për punen e kinotekes dhe kryen pune të tjera të percaktuara me aktin për themelim dhe statutin e kinotekes.

Financimi i kinotekave lokale

Neni 13

(1) Mjetet për financim të veprimtarise së kinotekave lokale sigurohen në menyre dhe procedure të percaktuar me ligj.

(2) Kinoteka ua dergon keshillit të komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit për miratim programin vjetor për pune, raportin për pune dhe planin financiar.

(3) Mjetet për themelim dhe punen e kinotekave lokale sigurohen nga buxheti i komunes.

Themelimi i kinotekave private

Neni 14

(1) Kinoteke private themelon personi vendes dhe i huaj juridik ose fizik, nën kushte dhe menyre të percaktuar me kete ligj ose ligj tjetër.

(2) Fondi i kinotekes private mund të marre statusin e të mires së mbrojtur nese në proceduren e percaktuar me Ligjin për mbrojtjen e trashegimise kulturore për të njejtin miraton akt perkates të mbrojtjes.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i ketij neni, në punen e kinotekes private, zbatohen edhe dispozitat që vlejne për poseduesit e të mirave të mbrojtura, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashegimise kulturore.

IV. TË PUNUARIT E KINOTEKAVE

Puna e kinotekave

Neni 15

Kinotekat vecanerisht i kryejne punet si vijon:

- grumbullojne, ruajne dhe shfaqin të mira audiovizuele,
- grumbullojne dhe ruajne sende teknike dhe materiale që kane të bejne me të mirat audiovizuele,
- ndermarrin masa teknike - mbrojtese për mbrojtjen e pajisjeve audiovizuele për shfaqjen e të mirave audiovizuele në medime të ndryshme,
- ndermarrin masa për mbrojtjen e të mirave audiovizuele të medimeve të posa vendosura,
- krijojne fonde dhe permbledhje të të mirave audiovizuele me origjine vendese dhe të huaj,
- mbajne evidence dhe dokumentacion për të mirat audiovizuele dhe formojne dhe mirembajne bazen e të dhenave,
- japin shenime bibliografike,
- bejne katalogjizimin e të mirave audiovizuele në pajtim me standardet nderkombetare,
- u mundesojne qasje te permbledhjet e tyre qytetareve, enteve kulturore-arsimore, enteve shkencore, shoqatave të qytetareve dhe subjekteve të tjera juridike për shkak të shfrytezimit të permbledhjeve audiovizuele për qellime shkencore, arsimore dhe kulturore,
- e promovojne trashegimine audiovizuele si menyre për afirmimin e llojllojshmerise kulturore,
- organizojne shfaqje publike të të mirave audiovizuele,

- shpallin informacione të lidhura me punen e tyre permes publikimeve, revistave ose ekspozitave dhe
- kryejne edhe pune të tjera të percaktuara me ligj dhe statut.

Kinoteka amë

Neni 16

Për shkak të perparimit dhe koordinimit të punes së kinotekave në territorin e Republikës së Maqedonise me kete ligj dhe me ligjin për mbrojtjen e trashëgimise kulturore, si kinoteke nacionale qendrore amë percaktohet Institucioni nacional – Kinoteka e Maqedonise (në tekstin e metejme: Kinoteka e Maqedonise).

Puna e Kinotekes së Maqedonise

Neni 17

(1) Kinoteka e Maqedonise i kryen punet si vijon:

- grumbullon, ruan, restauron dhe shfaq të mira audiovizuele me origjine vendese ose të huaj dhe dokumentacion audiovizuel me interes kulturor, artistik, historik ose shkencor,
- grumbullon, ruan, restauron sende teknike dhe materiale që kane të bejne me të mirat audiovizuele, ndersa jane me rendesi kulturore, shkencore dhe historike,
- ndermerr masa teknike - mbrojtese për mbrojtjen e pajisjes audiovizuele për shfaqjen e të mirave audiovizuele në medime të ndryshme,
- ndermerr masa për mbrojtjen e të mirave audiovizuele të medimeve të të sapovendosura,
- e organizon bashkepunimin ndermjet kinotekave në Republikën e Maqedonise;
- e koordinon punen e kinotekave,
- i jep mendim ministrit për plotesimin e kushteve nga neni 9 i ketij ligji,
- krijon fonde dhe permbledhje të të mirave audiovizuele me origjine vendese dhe të huaj,
- mban evidence dhe dokumentacion për të mirat audiovizuele dhe formon e miremban bazen e të dhenave,
- leshon shkresa bibliografike,
- bën katalogjizimin e të mirave audiovizuele në pajtim me standardet nderkombetare,
- i studion, hulumton dhe me metoda shkencore i perpunon ceshtjet nga sfera e mbrojtjes së të mirave audiovizuele,
- u jep ndihme profesionale poseduesve të të mirave audiovizuele,
- u mundeson qasje te permbledhjet e veta qytetareve, institucioneve kulturore - arsimore, institucioneve shkencore, shoqatave të qytetareve dhe subjekteve të tjera juridike për shkak të shfrytezimit të permbledhjeve audiovizuele për qellime shkencore, arsimore dhe kulturore,
- e promovon trashëgimine audiovizuele si menyre për afirmimin e llojllojshmerise kulturore,
- organizon shfaqje publike të të mirave audiovizuele,
- shpall informacione të lidhura me punen e vet neprmjet publikimeve, revistave ose ekspozitave dhe krijimin e UEB - faqes,
- jep iniciativa për miratimin e dispozitave dhe të masave për avancimin e veprimtarise për mbrojtjen e të mirave audiovizuele,
- merr pjese në programe nderkombetare për bashkepunim dhe shkembim të informacioneve për metodat dhe teknikat për ruajtjen e të mirave audiovizuele,
- anetaresohet në asociacione perkatese nderkombetare,
- bën mbikeqyrje në dergimin e ekzemplarit të detyrueshem,
- bën mbikeqyrje në gjendjet në veprimtarine për mbrojtjen e të mirave audiovizuele,
- kujdeset për persosjen e kuadrove profesionale në veprimtari,
- ndermerr masa për lidhje në rrjet me qendrat evropiane për mbrojtjen e të mirave audiovizuele, si asociacione relevante nga kjo sfare dhe
- kryen edhe pune të tjera të percaktuara me ligj dhe statut.

Veprimtarite tjera të kinotekave

Neni 18

(1) Gjate kryerjes së veprimtarise së veta themelore, si dhe veprimtarive të lidhura me to, kinotekat kryejne edhe pune me interes edukativ dhe shkencor.

(2) Kinotekat zhvillojne forma për popullarizimin e rendesise dhe të vlerave kulturore dhe shkencore të të mirave audiovizuele.

(3) Kinotekat permes organizimit të ekspozateve të perhershme dhe të perkohshme bejne prezantimin e sendeve teknike dhe materialeve shoqeruese.

Grumbullimi i të mirave audiovizuele

Neni 19

(1) Kinotekat grumbullojne të mira audiovizuele permes ekzemplarit vullnetar, grumbullimit, dhuratave, shkembimit, legatave, testamenteve si dhe permes terheqjes dhe ndermarrjes nga persona të tjere juridike dhe fizike.

(2) Përvec menyrave të grumbullimit të të mirave audiovizuele në paragrafin (1) të ketij neni Kinoteka e Maqedonise grumbullon të mira audiovizuele dhe permes dorezimit të ekzemplarit të detyrueshem.

(3) Për grumbullimin e të mirave audiovizuele zbatohet Ligji për të drejtat autoriale dhe të drejtat e ngjashme.

Ekzemplari i detyrueshem

Neni 20

(1) Për shkak të mbrojtjes, ruajtjes dhe shfrytezimit të të mirave audiviozuele Kinotekes së Maqedonise i dorezohet ekzemplari i detyrueshem, në pajtim me kete ligj.

(2) Producenti i të mirave audiovizuele (filmit artistik, dokumentar, eksperimental dhe alternativ), menjehere pas realizimit, Kinotekes së Maqedonise i dergohet një kopje e paperdorur tonike e të mires audiovizuele, pa marre parasysh llojin e bartesit, me dokument shoqerues.

(3) Producenti nga paragrafi (2) i ketij neni, për të mirat audiovizuele të financuara me mjetet nga Buxheti i Republikes së Maqedonise, dy vjet pas shfaqjes së tyre të pare Kinotekes së Republikes së Maqedonise ia dorezon materialet burimore të të mirave audiovizuele.

(4) Producenti nga Republika e Maqedonise, pjesemarres në bashke produksion të të mirave audivizuale, i cili ka shfrytezuar mjete nga Buxheti i Republikes së Maqedonise, menjehere pas realizimit, Kinotekes së Republikes së Maqedonise i dergon një kopje të paperdorur tonike të të mirave audiovizuele.

(5) Producenti nga Republika e Maqedonise, i cili me mjetet nga Buxheti i Republikes së Maqedonise ka marre pjese me pjesen shumice në vepren bashke produktive audiovizuele, dy vjet pas premieres, Kinotekes së Maqedonise ia dergon materialet burimore.

(6) Distributoret e të mirave audiovizuele të dedikuara për shfaqje kinemaje, pas skadimit të licences për shfaqje në territorin e Republikes së Maqedonise Kinotekes së Maqedonise i dergojne kopje të ruajtur nga çdo e mire audiovizuele.

(7) Producentet e programeve radiodifuze me interes publik të financuar me mjete nga taksa radiodifuze Kinotekes së Maqedonise i dergojne një kopje të paperdorur.

Ekzemplari vullnetar

Neni 21

(1) Organizatat radiodifuze me kerkese të kinotekave mund të dergojne kopje të paperdorshme të produksionit të vet artistik, dokumentar dhe të animuar televiziv.

(1) Poseduesit e të mirave audiovizuele me kerkese të kinotekave mund të dorezojne kopje nga të mirat audiovizuele.

(3) Kinotekat me kerkese të Kinotekes së Maqedonise mund të dergojne kopje nga të mirat audiovizuele.

(4) Shpenzimet për deponimin dhe perpunimin e kopjes jane në barre të kerkuesit.

Marreveshja për qasje dhe shfrytezim të ekzemplarit të deponuar

Neni 22

(1) Kinoteka e Maqedonise dhe subjektet nga neni 20 i ketij ligji, si dhe subjektet nga neni 21 i ketij ligji, lidhin marreveshje me të cilen rregullohen të drejtat e qasjes dhe shfrytezimit të të mirave audiovizuele, në pajtim me Ligjin për të drejte autoriale dhe drejtat e ngjashme.

(2) Deponuesit të të mirave audiovizuele kinotekat mund t'i lejojne berjen e kopjes së materialit të deponuar në llogari të tij, nese atë e lejon regjimi i mbrojtjes së të mires dhe jane rregulluar të drejtat autoriale dhe të drejtat e ngjashme.

Qasja dhe shfrytezimi i të mirave audiovizuele

Neni 23

(1) Të mirat audiovizuele të deponuara në kinoteka, jane të kapshme për publikun dhe mund të shfrytezohen për qellime kulturore, shkencore, arsimore dhe komerciale, nën kushte të percaktuara me regjimin e mbrojtjes së të mirave dhe në pajtim me Ligjin për të drejta autoriale dhe të drejtat e ngjashme.

(2) Kopja arkivore dhe materialet burimore të të mirave audivizuale nuk perdoren.

(3) Me perjashtim, sendet e theksuara në paragrafin (2) të ketij neni, mund të shfrytezohen vetem kur eshte e doemos e nevojshme berja e kopjeve të reja, për shkak të mbrojtjes së tyre dhe për nevojat e bartesve të së drejtes autoriale dhe të drejtave të ngjashme.

(4) Nese të mirat e kerkuara audiovizuele jane në menyre të pamjaftueshme të mbrojtura ose në kohen e shfrytezimit të tyre jane demtuar seriozisht, shfrytezuesit, kinotekat doemos duhen t'i ofrojne kopje nga të mirat audiovizuele të bartura në bartesi digjital, mikrofilm ose të mbrojtura në menyre tjeter.

(5) Nuk jane kapshme për shfrytezim të mirat audiovizuele, të cilat:

- jane në proces të perpunimit profesional dhe shkencor ose nuk u ka skaduar afati i pronesise shkencore,

- jane të demtuar deri në atë shkalle që të mos mund të shfrytezohen,

- nuk jane për momentin të kapshme për shkaqe të tjera dhe

- permbajne të dhena që jane të percaktuara si informacione të klasifikuara.

(6) Kinotekat jane të detyruara t'i arsyetojne shkaqet perse të mirat audiovizuele të kerkuara nuk mund të perdoren dhe të japin informacione kur do të jene të kapshme për shfrytezim.

Detyrimet e transportuesve

Neni 24

(1) Shfrytezuesit e sherbimeve jane të detyruar t'i respektojne rregullat për shfrytezimin e të mirave audiovizuele në pajtim me ligjin dhe me aktet e kinotekave.

(2) Kinotekat jane të detyruara që shfrytezuesve t'ua kumtojne rregullat për të drejtat dhe detyrimet e tyre në menyre perkatese dhe transparente.

(3) Shfrytezuesit, i cili nuk i respekton rregullat e percaktuara mund t'i pamundesohet shfrytezimi i metutjeshem i të mirave audiovizuele.

(4) Shfrytezuesi, i cili për kohen e shfrytezimit të të mirave audiovizuele, ka shkaktuar demtimin e të mirave, eshte i detyruar t'i mbuloje shpenzimet për konservimin perkatesisht restaurimin e tij.

(5) Shfrytezuesi eshte i detyruar që të mos i keqperdore të dhenat personale të mbrojtura me ligj dhe të dhenat të cilat jane të mbrojtura me Ligjin për të drejte autoriale dhe të drejtat e ngjashme.

(6) Shfrytezuesi është i detyruar që të mirat t'i shfrytëzojë në pajtim me Ligjin për të drejte autoriale dhe të drejtat e ngjashme.

Leja për shfrytëzim

Neni 25

(1) Kinotekat, në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së personit të interesuar, leshojnë leje për shfrytëzimin e të mirave audiovizuale.

(2) Kërkesa doemos duhet t'i përmbajë të dhënat si vijon:

- të dhënat personale për shfrytëzuesin,
- të dhënat për të mirat audiovizuale, të cilat i janë të nevojshme për t'i shfrytëzuar,
- qëllimet për shfrytëzimin e të mirave audiovizuale, dhe
- temën, sferën që do ta hulumtojë.

(3) Në lejen nga paragrafi (1) i këtij neni precizohet koha, vendi dhe metodat e përdorimit.

(4) Nëse kinotekat, në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, personit të interesuar nuk i leshojnë leje për shfrytëzimin e të mirave audiovizuale, konsiderohet se i është dhënë leje pozitive.

Kompensimi për shfrytëzim

Neni 26

(1) Shfrytëzimi i të mirave audiovizuale është pa kompensim.

(2) Për kryerjen e shërbimeve të vecanta të lidhura me shfrytëzimin e të mirave audiovizuale (fotokopjim, mikrofilmim, skenim, fotografim dhe forma të tjera të riprodhimit, kopjim të medimeve magnetike, optike dhe të tjera, konservimin dhe restaurimin e të mirave audiovizuale dhe tjera) kinotekat caktojnë kompensim adekuat.

(3) Llojin e shërbimeve dhe lartësine e kompensimit e përcaktojnë kinotekat me akt të vecantë.

(4) Lartësia e kompensimit përcaktohet në varshmeri nga nderlikueshmeria e shërbimit të kërkuar, përdorimit të mjeteve teknike, eksploatimit të të mirave audiovizuale, angazhimit profesional, si dhe qëllimeve për të cilat kërkohet shërbimi.

Shkëmbimi dhe shmangia

Neni 27

Të mirat audiovizuale të kinotekave, për shkak të plotësimit të përmbledhjeve ose realizimit të mbrojtjes efektive dhe prezantimit më të mirë, mund të shkëmbejnë ose perkohejshëm ose në mënyrë të përhershme të lihen institucioneve tjera publike për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe poseduesve të tjerë të përmbledhjeve audiovizuale në procedurën e përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe në pajtim me Ligjin për të drejte autoriale dhe të drejtat e ngjashme.

Ruajtja e të mirave audiovizuale

Neni 28

(1) Kinotekat, për shkak të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të përhershëm të të mirave audiovizuale, janë të detyruar t'i ruajnë në kushte të standardizuara dhe me zbatimin e mjeteve bashkëkohore teknike që sigurojnë mbrojtjen e tyre komplekse dhe efektive.

Revizioni i të mirave audiovizuale

Neni 29

(1) Kinotekat janë të detyruara të kryejnë revizionin e gjendjes së të mirave audiovizuale

(2) Me revizion rregullohet gjendja e të mirave audiovizuale dhe nevoja e ndërmarrjes së masave përkatëse për mbrojtjen e tyre efektive.

(3) Revizioni i të mirave audiovizuele behet së paku në çdo pese vjet.

Shlyerja e të mirave audiovizuele nga evidenca

Neni 30

Të mirat audiovizuele në kinoteka mund të shlyhen nga evidenca prej librit të inventarit, në baze të aktit për nderprerjen e mbrojtjes në menyre dhe procedure të percaktuar me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimise kulturore dhe me ligj tjetër.

(2) Shlyerjen e të mirave audiovizele, të cilat nuk janë të evidentuara në librin inventarit, behet në menyre dhe procedure të percaktuar me statutin e kinotekave.

V. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E POSEDUESVE TË TË MIRAVE AUDIOVIZUELE

Poseduesit e të mirave audiovizuele

Neni 31

(1) Posedues të të mirave audiovizuele në kuptimin e këtij ligji janë personat juridike ose fizike, të cilët në çfaredo baze tjetër juridike kanë në posedim të mira audiovizuele, ndërsa nuk janë të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë për mbrojtjen e të mirave audiovizuele.

(2) Posedues të të mirave audiovizuele në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni janë edhe personat juridike të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë radiodifuze, të cilët krijojnë fonde të të mirave audiovizuele.

(3) Poseduesit nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni, të mirat audiovizuele për të cilat supozohet se paraqesin trashëgimi kulturore, janë të detyruar që Kinotekës së Maqedonise t'i lejojnë t'i kryejë kerkimet dhe hulumtimet e domosdoshme të të mirave, për shkak të vendosjes së mbrojtjes.

(4) Poseduesit nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni, të cilët në produksionin e vet krijojnë vepra audiovizuele për të cilat mund të supozohet se kanë rendesi kulturore, shkencore, historike dhe rendesi tjetër, ndërsa për shkaqe objektive nuk kanë mundësi të sigurojnë kushte lokali dhe teknike për ruajtjen e veprave, mund t'ia dorezojnë Kinotekës së Maqedonise, për shkak të mbrojtjes së tyre.

(5) Kinoteka është e detyruar t'i pranojë të mirat nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Poseduesit e paragrafeve (1) dhe (2) të këtij neni kanë të drejtë ndihme profesionale nga Kinoteka e Maqedonise, pa kompensim lidhur me ruajtjen, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e të mirave audiovizuele.

(7) Kinoteka e Maqedonise është e detyruar ta japë ndihmen e kerkuar profesionale.

VI. EVIDENTIMI, DOKUMENTIMI DHE MBAJTJA E REGJISTRIT

Evidentimi dhe dokumentimi i të mirave audiovizuele

Neni 32

(1) Kinotekat janë të detyruara të kryejnë evidentimin dhe dokumentimin e të mirave audiovizuele.

(2) Evidentimi i të mirave audiovizuele permban librin hyres, librin për inventar, librin dales, kartoteken e të mirave audiovizuele, katalogun e të mirave audiovizuele, bazen elektronike të të dhënave personale dhe lloj tjetër të evidentimit.

(3) Dokumentacioni për të mirat audiovizuele permban të dhëna për të mirat audiovizuele të cilat janë të nevojshme për perpunimin tyre profesional, identifikimin, menyren dhe gjendjen në të cilën janë pajisur, ndryshimet e shkaktuara, proceset e perpunimit dhe tjetër.

(4) Kinotekat perpunimin profesional të së mires audiovizuele e kryejnë në afat prej një viti nga dita e regjistrimit të tyre në librin hyres deri në ditën e regjistrimit të tij në librin e inventarit.

(5) Ministri e percakton formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së librit hyres, librit të inventarit, librit dales, kartotekës dhe llojeve të tjera të evidentimit dhe dokumentacionit.

Regjistri qendror i veprave të botuara audiovizuele

Neni 33

(1) Kinoteka e Maqedonise mban Regjister qendror të veprave të botuara audiovizuele.

(2) Kinotekat dhe poseduesit e të mirave audiovizuele nga neni 31 të këtij ligji janë të detyruar t'i paraqesin të dhëna Kinotekës së Maqedonise për regjistrin qendror nga paragrafi (1) i këtij neni.

Ministri e percakton permbajtjen, menyren e mbajtjes, të ruajtjes dhe të shfrytëzimit të të dhënave të Regjistrin qendror nga paragrafi (1) i këtij neni.

VII. TITUJT PROFESIONALE

Kryerja e puneve profesionale në kinoteka

Neni 34

Në kinoteka punet profesionale i kryejnë punetore me tituj zgjedhor profesionale, pa tituj zgjedhore profesionale dhe punetoret me tituj tjere profesionale.

Titujt zgjedhore profesionale

Neni 35

Punet profesionale në kinoteka i kryejnë punetor me tituj zgjedhore:

- filmolog i larte dhe
- filmolog keshilltar.

Kushtet e vecanta për zgjedhjen e filmologut të larte

Neni 36

(1) Me titullin filolog i larte mund të jete personi i zgjedhur i cili:

1) ka kryer studimet e magjistratures nga sfera perkatese dhe tre vjet pune si filmolog ose së paku dhjete vjet pune si filmolog;

2) ka botuar dhe të realizuar projekte profesionale me rendesi për avancimin e veprimtarise për mbrojtjen e të mirave audivizuale dhe

3) ka aftesi për organizimin e pavarur të punes profesionale.

(2) Personi i zgjedhur në titullin nga paragrafi (1) i këtij neni rizgjidhet pas skadimit të çdo të pestit vit.

Kushtet e vecanta për zgjedhjen filmologut - keshilltar

Neni 37

(1) Në titullin filmolog keshilltar mund të jete personi i zgjedhur i cili:

1) ka doktoraten e shkencave nga sfera perkatese dhe tre vjet pune si filmolog i larte ose së paku dhjete vjet pune si filmolog i larte;

2) ka projekte të botuara profesionale të dalluara, dhe të realizuara me rendesi të vecante për avancimin e veprimtarise për mbrojtjen e të mirave audiovizuele për sferen më të ngushte për të cilën zgjidhet dhe

3) ka shkalle të larte pavaresie në organizimin e punes profesionale.

(2) Personi i zgjedhur në titullin nga paragrafi (1) i këtij neni rizgjidhet pas skadimit të çdo të pestit vit.

(3) Personi i zgjedhur në titullin nga paragrafi (1) i këtij neni, pas rizgjedhjes së pare nuk rizgjidhet.

Kompetenca dhe procedurat për zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titullin zgjedhor profesional

Neni 38

(1) Zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titujt zgjedhore profesionale nga neni 36 dhe 37 i këtij ligji e bën ministri, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimise kulturore, në baze të vleresimit të komisionit recensues.

(2) Procedura për zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titull profesional ngrihet me kërkesen e punëtorit të interesuar profesional. Procedura për rizgjedhje mund të ngrihet dhe me iniciativën e drejtorit të kinotekës ose nga ana e organit të administrimit të kinotekës, më së voni në afat prej tre muajsh para skadimit të afatit për rizgjedhje.

(3) Komisionin e recensionit nga paragrafi (1) i këtij neni e emëron ministri, përbehet prej së paku tre anëtarësh, të zgjedhur nga radhët e personave të cilët e kanë së paku të njëjtin titull me të cilin behet zgjedhja, përkatësisht rizgjedhja ose kanë titull përkatës shkencor. Më tepër se gjysmën e anëtarëve të Komisionit e përbejnë personat e sferës së njëjte profesionale për të cilën zgjidhet kandidati.

(4) Komisioni recensues dorezon raport në formë të shkruar në afatin e përcaktuar me aktin për formimin e tij.

(5) Raporti nga paragrafi (4) i këtij neni përmban të dhëna për kandidatin, pasqyrën dhe vlerësimin për punën e tij profesionale dhe vlerësimin e plotësimit të kushteve për zgjedhje përkatësisht rizgjedhje.

(6) Procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titullin profesional më së shumti zgjat tre muaj.

Titujt jozgjedhore profesionale

Neni 39

Punët profesionale në kinoteka i kryejnë punëtorët me tituj jozgjedhore profesionale të cilët kanë arsim përkatës profesional për titullin teknik filmi, arsim përkatës të lartë për titullin teknik filmi i lartë dhe arsim të lartë përkatës për titullin filmolog, në pajtim me aktet e përgjithshme të kinotekave.

Titujt tjere

Neni 40

Punë të caktuara profesionale në kinoteka mund të kryejnë edhe punëtorët të cilët posedojnë njohuri shkencore, si dhe njohuri profesionale në sferën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, lëndës arkivore dhe punëtore tjere, në pajtim me aktin e përgjithshëm të kinotekës.

VIII. MBIKEQYRJE

Kryerja e mbikeqyrjes

Neni 41

(1) Mbikeqyrjen mbi zbatimin e këtij ligji e bën Ministria e Kulturës.

(2) Gjate kryerjes së mbikeqyrjes mbi punën e organeve të komunes, ministria i kryen punët si vijon:

1) e përcjell ligjshmerinë e punës së organeve të komunes dhe ndermerr masa dhe aktivitete dhe ngrit iniciativë për realizimin e kompetencave të komunes në pajtim me këtë ligj;

2) vlerëson nëse organet e komunes i sigurojnë kompetencat e komunes që të kryhen në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara me këtë ligj;

3) jep rekomandime për zbatimin konsekuent të kompetencave të komunes në suazat e përcaktuara me këtë ligj, me kërkesën e organeve të komunes;

4) e përcjell ligjshmerinë e aktvendimeve që i miraton kryetari i komunes në zgjidhjen e të drejtave individuale gjatë zgjedhjes së drejtorit të kinotekës dhe

5) në kohë i njofton organet e komunes për gjendjet e konstatuara në punën e tyre dhe për masat e ndermarra gjatë kryerjes së mbikeqyrjes.

(3) Mbikeqyrje inspektuese mbi zbatimin këtij ligji bën Ministria e Kulturës përmes inspektoreve për kulturë në pajtim me Ligjin për kulturë dhe Drejtorinë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

IX. DISPOZITAT PËR KUNDERVAJTJE

Sanksionet për kundervajtje

Neni 42

(1) Gjoke në shume prej 1.500 deri në 2.000 euro me kundervlere në denare, do t'i kumtohet për kundervajtje personit juridik, nese:

1) kryen veprimtari pa aktvendim se i ploteson kushtet për fillimin me pune të kinotekes (neni 9 paragrafi (2));

2) nuk i dorezon Kinotekes së Maqedonise kopje të paperdorur tonike të së mires, menjehere pas realizimit të vepres (neni 20 paragrafi (2));

3) nuk ia dorezon Kinotekes së Maqedonise materialet burimore të të mirave audiovizuele dy vjet pas shfaqjes së tyre si premiere (neni 20 paragrafi (3));

4) nuk i dorezon Kinotekes së Maqedonise kopje të paperdorur tonike të së mires, menjehere pas realizimit të saj (neni 20 paragrafi (4));

5) nuk ia dorezon Kinotekes së Maqedonise materialet burimore të të mirave audiovizuele dy vjet pas shfaqjes së tyre si premiere (neni 20 paragrafi (5));

6) nuk dorezon Kinotekes së Maqedonise një kopje më të ruajtur nga çdo e mire audiovizuele, menjehere pas skadimit të licences për shfaqje në territorin e Republikës së Maqedonise (neni 20 paragrafi (6));

7) nuk i dorezon Kinotekes së Maqedonise një kopje të paperdorur tonike (neni 20 paragrafi (7));

8) nuk mban evidence dhe dokumentacionin e të mirave audiovizuele (neni 32);

9) nuk bën revizionin e të mirave audiovizuele (neni 29); dhe

10) në afatin e percaktuar nuk e perpunon profesionalisht të miren audiovizuele (neni 32 paragrafi (4));

(2) Për veprimet nga paragrafi (1) i ketij neni, gjoke në shume prej 500 deri në 800 euro me kundervlere në denare, do t'i kumtohet për kundervajtje personit pergjegjes në personin juridik.

Barazimi

Neni 43

(1) Për kundervajtjet në nenin 42 të ketij ligji, inspektoret për kulture jane të detyruar që kryeresit të kundervajtjes t'i propozojne procedure për barazim para se të parashtrojne kerkese për procedure për kundervajtje.

(2) Kur kryeresi i kundervajtjes pajtohet për ngritjen procedures për barazim, inspektori për kulture perpilon procesverbal në të cilin shenohen elementet qenesore të kundervajtjes, koha, vendi dhe menyra e kryerjes së kundervajtjes, pershkrimi i veprimit të kundervajtjes dhe personat e prekur në vendin e ngjarjes.

(3) Në procesverbal percaktohet menyra në të cilen do të menjanohen pasojat e demshme nga kundervajtja, si dhe menyra e tejkalimit të pasojave nga kryerja e kundervajtjes.

(4) Inspektori për kulture në proceduren për barazim të kryeresit të kundervajtjes mund t'i jape urdherpagese.

(5) Nese kryeresi e pranon urdherpagesen eshte i detyruar të njejtin ta nenshkruaje. Pranimi i urdherpageses për kryeresin e kundervajtjes shenohet në procesverbal.

(6) Kur si kryeres i kundervajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdherpagesen e nenshkruajne personi zyrtar, perkatesisht pergjegjes i cili eshte gjendur në vendin e ngjarjes gjate mbikeqyrjes së inspektimit ose person tjetër zyrtar ose personi pergjegjes i cili ka deklaruar se ka të drejte ta nenshkruaje procesverbalin dhe ta pranoje urdherpagesen.

(7) Deklarata nga paragrafi 6 i ketij neni shenohet në procesverbal.

(8) Inspektoret për kulture jane të detyruar të mbajne evidence për procedurat e ngritura për barazim dhe për epilogun e tyre.

Kompetenca e gjykates

Neni 44

Proceduren për kundervajtje për kundervajtjet nga neni 42 i këtij ligji e mban gjykata kompetente.

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Aktet nenligjore

Neni 45

Dispozitat miratimi i të cilave është parapare me kete ligj do të miratohen më së voni në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Harmonizimi i punes

Neni 46

Kinoteka e Maqedonise do ta harmonizojë punën e vet dhe aktet e vecanta me dispozitat e këtij ligji në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Titujt profesionale

Neni 47

(1) Personave të cilet deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë fituar titullin filmolog i larte dhe filmolog keshilltar në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e trashëgimise kulturore titulli i fituar u pranohet.

(2) Procedurat për fitimin e titujve filmolog i larte dhe filmolog keshilltar të filluara në baze të dispozitave për mbrojtjen e trashëgimise kulturore, do të perfundojnë në baze të dispozitave të këtij ligji.

Riemertimi i kinotekes amë

Neni 48

Institucioni Nacional i gjertanishem - Kinoteka e Republikës së Maqedonise, me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të punojë si Institucion nacional - Kinoteka e Maqedonise.

Pushimi i ligjit ekzistues dhe pushimi i vlefshmerise së dispozitave

Neni 49

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon Ligji për themelim të Kinotekës së Republikës Socialiste të Maqedonise ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 20/1974) dhe dispozitat e Ligjit për ekzemplarët e detyrueshem ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer 11/1994) që kanë të bëjnë me dergimin e ekzemplarëve të detyrueshem kinotekës së Republikës së Maqedonise.

Hyrja në fuqi e ligjit

Neni 50

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tete nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonise".